




Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën:

NJOFTIMIN

PËR

TAKIMIN E PARË PUBLIK TË KRYETARIT



Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët e tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, organizon takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

Takimi publik me qytetarë do të mbahet më datë: **23.6.2025 (e hënë), në orën 10:00**, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec. Në këtë takim do të keni mundësi të njiheni me punën e qeverisë komunale në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Po ashtu qytetarët pjesëmarrës në takim mund t'i bëjnë pyetje dhe komente ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre u interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datë: **20.6.2025** në orën **16:00**, në e-mailat: ardit.halilaj@rks-gov.net dhe blerta.gashi@rks-gov.net

Jeni të mirëpritur!

